



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 11.07.2023, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1181/23, për zyrtaren e lartë znj. Lorika Gashi, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, Komuna e Suharekës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

## A r s y e t i m

Rasti i hapur (sipas detyrës zyrtare) nën dyshimin për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Lorika Gashi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se znj. Lorika Gashi, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë publike, respektivisht Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, Komuna e Suharekës, është edhe përfaqësuese e autorizuar - drejtor menaxhues në biznesin privat "Lika Derm" SH.P.K.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-01/1221/23, duke e njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë. Më pas e njëjta është kontaktuar dhe sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, ajo nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësuese e autorizuar në biznes privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.*

Pas sqarimit dhe diskutimit të fakteve, zyrtarja e lartë është pajtuar me gjetjet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare, me të cilën dëshkohet se zyrtarja e lartë znj. Lorika Gashi ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia dhe se e njëjta nuk figuron më të jetë Drejtor e as Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat në fjalë.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë, përkatësisht transferimin e të drejtave në drejtimin e biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

  
Vl. Buleshkaj  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

